



KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 02/L-115

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR LIKUIDIMIN DHE RIORGANIZIMIN E PERSONAVE JURIDIK NË FALIMENTIM

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në kreun 5.1 (a), (b) dhe 9.1.26 (a), të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9, dt.15 maj 2001),

Duke pasur parasysh, se detyrimet tatimore të subjekteve juridike në falimentim pas shpenzimeve për likuidim janë njëra ndër kërkesat me prioritet për realizim dhe më qëllim të zbatimit të plotë të ligjit nr. 2003/4 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/7 për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim

Miraton :

LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/4 PËR LIKUIDIMIN DHE RIORGANIZIMIN E PERSONAVE JURIDIK NË FALIMENTIM

Neni 1

Neni 65.1 i Ligjit nr.2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

d) “Detyrimet tatimore të pashlyera deri në momentin e hapjes së procedurës së falimentimit.

Pika ekzistuese (d) bëhet (e) ndërsa pika (e) bëhet (f), në tekstin e ligjit nr. 2003/4 .

Neni 2

Ky ligj hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe Shpalljes nga përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-115
21 qershor 2007

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Kolë Berisha